



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të KQZ kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i KQZ-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i KQZ-së është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i KQZ-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fushë për përmirësim të mundshëm, të paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjes dhe rekomandimit. Kjo ka për qëllim të përmirësojë kontrollet e brendshme lidhur me mangësitë në Pasqyrat Vjetore Financiare.

Ky raport ka rezultuar me një rekomandim të ri. Ne do ta përcjellim (shqyrtojmë) këtë rekomandim gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

Çështja C1 - Mangësi në raportimin dhe shpalosjen e buxhetit final në PVF

Gjetja	<p>Rregullorja e MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 14, përcakton se pasqyra e ekzekutimit të buxhetit duhet të paraqesë buxhetin fillestar, buxhetin final sipas SIMFK-së, realizimin dhe krahasimin ndërmjet tyre. Sipas pikës 3, buxheti final duhet të përfshijë vetëm përshtatjet e lejuara gjatë vitit, si fondet e bartura, transferet e autorizuara ndërmjet programeve dhe ndryshimet në Ligjin Vjetor të Buxhetit, dhe duhet të jetë i barabartë me ndarjen përfundimtare në SIMFK. Po ashtu, ndryshimet buxhetore gjatë vitit duhet të shpalosen si analizë ndërmjet buxhetit fillestar dhe atij përfundimtar sipas kategorive.</p> <p>Gjatë rishikimit të PFV-ve kemi identifikuar se te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit (dalja e parasë së gatshme) buxheti final ishte paraqitur më i lartë për 24,997€ krahasuar me ndarjen përfundimtare në SIMFK. Si pasojë, edhe te neni 14.6 - Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit, KQZ-ja nuk kishte shpalosur saktë informacionet lidhur me ndarjet finale të buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale.</p> <p>Kjo kishte ndodhur për shkak të mosreflektimit të saktë të ndryshimeve buxhetore gjatë përgatitjes së PFV-ve dhe mungesës së kontrolleve të mjaftueshme në procesin e rishikimit të tyre.</p>
Ndikimi	<p>Mosparaqitja e saktë e buxhetit final dhe e shpalosjeve përkatëse në PFV ndikon në prezantimin jo të saktë të ekzekutimit të buxhetit dhe zvogëlon besueshmërinë e informacionit financiar të raportuar për përdoruesit e PFV-ve.</p>
Rekomandimi C1	<p>Kryetari i KQZ-së duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme gjatë përgatitjes dhe rishikimit të PFV-ve, në mënyrë që informacionet e paraqitura në raportet financiare të jenë të plota, të sakta dhe në përputhje me ndarjet përfundimtare në SIMFK.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjate auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështja 1

Mos pajtueshmëritë lidhur me deklaratimet në Pasqyrat Vjetore Financiare

Gjetja

Në Pasqyrat Vjetore Financiar të KQZ-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025, kemi identifikuar mos-pajtueshmëritë në deklarime si në vijim:

1. Neni 13 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme:
 - Te burimet e fondeve, vlera e pranimeve nga granti qeveritar, nuk ishte prezantuar saktë për vitin 2025;
 - Te shfrytëzimi i fondeve, vlerat e shpenzimeve për të gjitha kategoritë e shpenzimeve për vitin 2025, si dhe për kategorinë mallra dhe shërbime e shpenzime komunale për vitin 2023, nuk ishin prezantuar saktë;
2. Neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit, tek hyrja e parasë së gatshme, nuk ishin shpalosur buxheti fillestar dhe buxheti final për të hyrat jo tatimore;
3. Shpalosjet:
 - Neni 24 - Raporti për fondet e donatorëve të pashpenzuara, nuk ishin shpalosur vlerat për saldon e donacioneve;
 - Shënimi 9 - Të hyrat jo tatimore, vlerat e realizimit të të hyrave për vitet krahasuese, 2024 dhe 2023, nuk ishin prezantuar saktë;
 - Neni 17 - Raport për detyrimet (faturat) e papaguara, vlera e detyrimeve të papaguara nuk ishte prezantuar saktë në shifrat krahasuese për vitet 2024 dhe 2023;
 - Neni 18 - Detyrimet kontingjente, vlera e detyrimeve kontingjente nuk ishte prezantuar saktë në shifrat krahasuese për vitet 2024 dhe 2023; si dhe
 - Neni 25 - Raport për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave, nuk ishte bërë klasifikimi dhe renditja e saktë në kolonat përkatëse për vitin 2025.

Veprimi i kërkuar

KQZ-së i është kërkuar të bëjë korrigjimet e nevojshme në Pasqyrat Vjetore Financiare me qëllim të sigurimit të paraqitjes së saktë dhe të plotë të informacionit financiar.

Rezultati

KQZ ka ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe ka korigjuar shumicën e mos-pajtueshmërive të identifikuara, në përputhje me kërkesat ligjore, përveç çështjes lidhur me raportimin e buxhetit final, e cila nuk është adresuar nga entiteti dhe, për rrjedhojë, është trajtuar si gjetje e auditimit në raportin e auditimit.

Megjithatë, KQZ duhet të ketë në vëmendje forcimin e kontrolleve të brendshme në procesin e përgatitjes dhe rishikimit të raporteve financiare, me qëllim të parandalimit të përsëritjes së çështjeve të ngjashme në të ardhmen. Në rast të përsëritjes, çështja do të trajtohet si gjetje me rekomandim përkatës.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	22,327,635	28,086,731	26,937,478	6,937,609	5,779,642
Grante Qeveritare - Buxheti	22,327,635	28,085,154	26,937,478	6,937,609	5,779,642
Donacionet e jashtme	0	1,577	0	0	0

Buxheti përfundimtar është më i lart se buxheti fillestar për 5,759,096€. Kjo rritje ishte rezultat i ndarjeve shtesë buxhetore të aprovuara me vendime të Qeverisë për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme.

Në vitin 2025 KQZ ka shpenzuar 96% të buxhetit përfundimtar ose 26,937,478€, me një rritje prej 27% në krahasim me vitin 2024.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	22,327,635	28,086,731	26,937,478	6,937,609	5,779,642
Pagat dhe mëditjet	1,236,537	1,282,653	1,282,653	1,064,303	1,004,360
Mallrat dhe shërbimet	15,748,998	21,210,575	20,117,855	1,065,986	567,547
Komunalitë	28,100	28,100	17,748	7,320	7,736
Subvencionet dhe transferet	4,800,000	4,900,800	4,860,799	4,800,000	4,200,000
Investimet Kapitale	514,000	664,603	658,422	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 46,116€, si rezultat i mjeteve shtesë me vendimeve të qeverisë. Realizimi i buxhetit final ishte 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime, në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 5,461,577€. Kjo rritje ishte rezultat e vendimit të Qeverisë në vlerë 5,460,000€ dhe donacioneve të pashpensuara të viteve të mëhershme në vlerë 1,577€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 95%;
- Buxheti final për shërbime komunale ishte i njëjtë me buxhetin fillestar, ndërsa realizimi i buxhetit final ishte 63%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere, në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 100,800€, si rezultat i vendimit të Qeverisë për mjete shtesë. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 99%;
- Buxheti final për investime kapitale, në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 150,603€. Fillimisht, buxheti ishte rritur për 525,000€ me vendim të Qeverisë, ndërsa më pas ishte zvogëluar për 374,397€ si rezultat i shkurtimeve buxhetore. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 99%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga KQZ gjatë vitit 2025 ishin në vlerë prej 45,592€, Këto të hyra ishin realizuar kryesisht nga regjistrimi i subjekteve të reja politike dhe nga gjobat e subjekteve politike.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	0	0	45,592	81,550	6,600
Të hyrat jo tatimore	0	0	45,592	81,550	6,600

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2024 ka rezultuar në tri rekomandime. KQZ kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, një rekomandim ishte zbatuar, një rekomandim ishte zbatuar pjesërisht dhe një rekomandim nuk është i aplikueshëm më. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari i KQZ-së duhet të sigurohet që mangësitë dhe gabimet e tilla të mos përsëriten gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të vitit 2025 si dhe PFV-të të mos dorëzohen në Thesar para se t'i nënshtrohen një rishikimi të detajuar nga ana e menaxhmentit.	Gjatë vitit 2025, kjo gjetje është përsëritur pjesërisht, për shkak të një gabimi në PFV. Ref.C1	Pjesërisht i zbatuar
2.	Pasuritë	Kryetari i KQZ-së duhet të sigurojë që procesi i inventarizimit të pasurisë të kryhet me kohë dhe këto raporte të harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe t'i paraprijnë përgatitjes së PFV.	Ky rekomandim konsiderohet i mbyllur për shkak të natyrës dhe rëndësisë së çështjes së trajtuar.	Nuk është i aplikueshëm më
3.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari i KQZ-së duhet të sigurojë funksionalizimin e komitetit të auditimit të brendshëm në mënyrë që komiteti të kryej rolin dhe detyrat sipas përgjegjësisë të dhëna në legjislacionin në fuqi duke përfshi edhe forcimin sistemit të kontrollit të brendshëm dhe mbikëqyrjen e njësisë së auditimit të brendshëm	Komiteti i Auditimit të KQZ-së është funksionalizuar gjatë vitit 2025.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Shqiponja Krasniqi, Udhëheqëse e ekipit



Mazlumsha Sejfadini, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Kreshnik Radoniqi, Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Prishtinë, 3.06.2026



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.